



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 03-299-2023;

Data: 05.06.2023

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të nenit 5, shkronja b) të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 02L-52 mbi Edukimin Parashkollor, në nenin 4 paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) nr. 03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë, Drejtoria e Arsimit shpallë këtë:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE
PUBLIKE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR VITIN EDUKATIV 2023/2024

Vendet e lira në Institucionet parashkollore 2023-2024

Grup-mosha	IP. Dielli	IP. Yllkat	IP. Fatosat	IP. Xixëllonjat	IP. Buzëqeshja	IP. Ardhmëria	IP. Lulevera	IP. Gëzimi Ynë	Gjithsej
1- > 2 vjeç	24	30	30	10	10	12	20	46	182
2- > 3 vjeç	0	0	0	14	12	0	0	11	37
3- > 4 vjeç	7	18	0	13	10	4	11	19	82
4- >5 vjeç	0	0	0	0	0	0	0	8	8
5- >6 vjeç	0	0	0	0	0	2	0	10	12
3-6 vjeç	0	0	0	0	0	0	0	6	6
Gjithsej	31	48	30	37	32	18	31	100	327

I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Formulari i aplikimit (merret në institucionin përkatës parashkollor);
- Dokumenti personal i prindit (letërnjoftim ose pasaportë);
- Ekstraktin e lindjes së fëmijës;
- Vërtetim vendbanimi nga Bashkësia Lokale;
- Faturën e shërbimeve komunale, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Për qiramarrësit – Kontratë e noterizuar mbi qiranë;
- Dëshmia nga mjeku për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të fëmijës;
- Dëshmia për vaksinimin e fëmijës (fletorja e shëndetit të fëmijës);
- Vërtetimi për marrëdhënien e punës për të dy prindërit (nëse prindërit janë në marrëdhënie pune);
- Pasqyra e Trustit për gjashtë (6) mujorin e fundit;
- Dëshminë që ka fëmijë të tjerë të regjistruar në institucionin parashkollor përkatës;
- Dokumente të tjera origjinale ose të noterizuara për të dëshmuar kategorinë përkatëse të specifikuar në Vendimin e Drejtorisë së Arsimit nr. 03-296-2023 të dt. 06.06.2023.

II. Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të fëmijëve në institucionet parashkollore

Regjistrimi i fëmijëve në IP do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushë e arsimit parashkollor (Ligjit nr. 02L-52 mbi Edukimin Parashkollor), në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2022 për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë dhe në Vendimin e kriterëve të pranimit të fëmijëve në institucionet parashkollore publike të Drejtorisë së Arsimit nr. 03-296-2023 të dt. 05.06.2023.

III. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur nga data e publikimit më **06.06.2023 deri më datën 17.06.2023;**
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në institucionin parashkollor përkatës **çdo ditë pune prej orës 09:00 deri në ora 15:00;**
- Shpallja e rezultateve bëhet më **datën 27.06.2023** në institucionet parashkollore përkatëse;
- Palët e pakënaqura me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë ankesë në institucionin parashkollor përkatës në afat prej tetë (8) ditëve pas datës së publikimit të rezultateve;
- Palët e pakënaqura me përgjigjen e IP-së, mund të ushtrojnë ankesë në DKA, si shkallë e dytë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve; DKA nuk shqyrton asnjë ankesë, nëse e njëjta nuk është shqyrtuar me shkrim nga IP përkatëse.
- **Të gjitha dokumentacionet e pakompletuara dhe jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.**



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 03-296-2023;

Data: 05.06.2023

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenin 57 shkronja e. të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, në ligjet që rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji nr. 02/L-52, Ligji nr.03/L-068, Ligji nr.04/L-32 dhe Ligji nr.04/L-138), në nenin 4 paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) nr. 03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë, Drejtoria e Arsimit merr këtë:

V E N D I M

PËR KRITERET E PRANIMIT TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE PUBLIKE

- I. Vetëm fëmijët e prindërve që janë banorë të komunës së Prishtinës mund të regjistrohen në institucionet parashkollore publike (IP) të Komunës së Prishtinës;
- II. Planifikimin për numrin e fëmijëve që do të pranohen në IP e bëjnë vetë IP-të, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore të IP-ve;
- III. Në institucionet parashkollore publike mund të regjistrohen fëmijët prej moshës 9 muaj deri në 6 vjeç;
- IV. Llogaritja e moshës së fëmijëve nuk bëhet duke marrë parasysh datën e regjistrimit, por datën e fillimit të shërbimit, përkatësisht duke marrë parasysh **datën 31 Gusht**;
- V. Nëse Komisioni i pranimit të fëmijëve gjatë procesit të regjistrimit konstaton se ka dy e më shumë fëmijë me pikë të barabarta, atëherë duhet praktikuar shortin, i cili bëhet në prani të prindërve të fëmijëve dhe KDSH-së përkatëse. E njëjta procedurë kur fëmijët kanë pikë të barabarta vlen edhe për fëmijët që mbesin në listën pritëse (të papranuar), që sistemohen përgjatë vitit edukativ;

VI. Pranimi i fëmijëve në IP bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat bazuar në kriteret e specifikuara në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Kategoria	
1	Fëmijët bonjakë pa të dy prindërit	100
2	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i punësuar	90
3	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i papunësuar	80
4	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse të dy prindërit punojnë	80
5	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse njëri prind punon	60
6	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse asnjëri prind nuk punon	40
7	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i punësuar	60
8	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i papunësuar	30
9	Prindërit e fëmijëve në asistencë sociale	50
10	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	40
11	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon	30
12	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon	20
13	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	20
14	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon	15
15	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon	10
16	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve deri në 400 euro)	45
17	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve 401-700 euro)	35
18	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve 701-1000 euro)	25
19	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve mbi 1000 euro)	15
20	Fëmijët e prindërve që janë banues në lagjen – Bashkësinë Lokale ku gjendet IP-ja	20
21	Fëmijët e punëtorëve të IP-ve	10

22	Fëmijët e prindërve që tashmë e kanë një fëmijë vijues në IP-në përkatëse	10
23	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit deri në 300 euro)	20
24	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit 300 - 700 euro)	15
25	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit 701 - 1000 euro)	10
26	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura mujore të prindit mbi 1000 euro)	5

VII. Të gjitha statuset e të gjitha kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmohen me dokumente valide të lëshuara nga institucionet relevante;

VIII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 03 nr.171-22, dt.10.06.2022, për kriteret e pranimit të fëmijëve në institucionet parashkollore publike;

IX. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Institucioneve parashkollore publike (IP);
- Drejtorisë së Arsimit.


Besianë Musmurati
DREJTORE E ARSIMIT



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 03-297-2023;

Dt. 05.06.2023

Bazuar në dispozitat e nenit 24.2 dhe 24.5 të Ligjit nr. 02/L-52 mbi edukimin parashkollor, nenin 3 të UA nr. 41/2007, të dt. 9.10. 2007 për zbritjen e tarifave që duhet të paguhen nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore, nenit 4, paragrafi 1 të UA Nr. 03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në Institucione parashkollore në Kosovë, nenin 2, paragrafi 2.3 të Rregullores 01 nr. 110-157460, dt. 01.07.2014 për të hyrat vetanake të Institucioneve Arsimore të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, Drejtoria për Arsim publikon këtë:

NJOFTIM

1. Për lirim nga pagesa për fëmijët në Institucione Parashkollore publike për vitin edukativ 2023/2024.

Të drejtë lirimi nga pagesa kanë vetëm:

- a) Fëmijët e invalidëve të luftës lirohen nga pagesa 100%;
- b) Fëmijët bonjakë (pa të dy prindërit) 100%;
- c) Fëmijët me nevoja të veçanta 100%;
- d) Fëmijët në asistencë sociale 100%;
- e) Fëmijët me njërin prind lirohen 100%;
- f) Fëmijët e veteranëve të luftës 100%;
- g) Prindërit që kanë më shumë se një fëmijë në IP të regjistruar, për një fëmijë do ta paguaj tarifën e plotë, për fëmijën e dytë lirohet 30%, për fëmijën e tretë lirohet 50% nga tarifa aktuale (kjo kategori mund të aplikoj vetëm në një Institucion Parashkollor).

2. Të gjithë parashtruesit e kërkesave duhet t'i paraqesin dokumentet, si vijon:

- Kërkesën për lirim nga pagesa për vitin 2023/2024;
- Certifikatën e lindjes së fëmijëve;
- Kopjen kontratës me IP.

Invalidët e luftës duhet të paraqesin edhe:

- Vendimin origjinal (ose kopjen e vërtetuar të noteri) të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të pensionit për invalid të luftës.

Prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta edhe:

- Vërtetimin zyrtar për fëmijën me nevoja të veçanta (vërtetimi nga HANDIKOS apo nga Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale).

Prindërit e fëmijëve në asistencë sociale edhe:

- Vërtetimin zyrtar që dëshmon periudhën aktuale që janë në asistencë sociale nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kujdestaret fëmijëve bonjakë (pa të dy prindërit) edhe:

- Certifikatën e vdekjes së prindërve (origjinale).

Prindi i vetëm pa bashkëshorte/bashkëshort edhe:

- Certifikatën e vdekjes së bashkëshortit/ës (origjinale).

Prindi vetë ushqyes edhe:

- Dëshmi nga Gjykata ose konstatim (dokument zyrtar) nga Qendra për Punë Sociale se njëri nga prindërit është duke u kujdesur për fëmijët.

Prindërit që kanë me shumë se një fëmijë të regjistruar në çerdhet publike edhe:

- Certifikatën e lindjes të secilit fëmijë (origjinale) dhe fletëregjistrimin e tyre në institucionet përkatëse.
- Për të gjitha rastet e liruara nga pagesa prindërit/kujdestarët ligjor, duhet të dëshmojnë me dokument zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kërkesën e lirimit, në të kundërtën e njëjta do të refuzohet.

3. Lirimi nga pagesa, bëhet nga 1 shtatori i vitit 2023 deri më dt. 31 Gusht 2024.

3.1 Kërkesat dorëzohen në administratën e IP-së përkatëse.

3.2 Afati për paraqitjen e kërkesës për lirim nga pagesa është nga data 06.06.2023 deri më datën 17.06.2023.

U dorëzohet:

- Institucioneve parashkollore publike (IP);
- Drejtorisë së Arsimit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 03-298-2023;

Dt. 05.06.2023

Bazuar në dispozitat e nenit 62 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), në nenin 33.1 të Ligjit të Punës nr.03/L-212, nenin 57 shkronja e. të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Drejtoria e Arsimit merr këtë:

V E N D I M

- I. Pushimi vjetor kolektiv për vitin 2023 për të gjitha institucionet parashkollore publike të Komunës së Prishtinës do të shfrytëzohet nga data **24 Korrik 2023 deri më 11 Gusht 2023**;
- II. Të punësuarit në Institucionet parashkollore publike obligohen të fillojnë punën më datën **14 Gusht 2023**;
- III. Shfrytëzimi i pushimit vjetor kolektiv bëhet me qëllim të renovimeve të objekteve parashkollore dhe realizimin e dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit të IP-ve;
- IV. Të punësuarit në Kuzhinën Qendrore rekomandohen t'i përmbahen afatit të shfrytëzimit të pushimit vjetor të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi;
- V. Nëse të punësuarve të IP-së u mbetet pushim vjetor i pashfrytëzuar, atëherë pushimi vjetor i tyre shfrytëzohet në koordinim me drejtorin e institucionit përkatës. Ndërsa, Drejtori i IP-së shfrytëzon pushimin vjetor pas aprovimit nga DKA.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Institucioneve parashkollore publike (IP);
- Kuzhinës Qendrore;
- Drejtorisë së Arsimit.

Besianë Musmurati
DREJTORE E ARSIMIT